

EPO FARBE SV



PËRSHKRIMI

Bojë për sipërfaqe metalike dy komponentësh me bazë epokside, e disponueshme në disa ngjyra të ndryshme

KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

- Rezistencë UV
- Shkëlqim i lartë
- Ngjitje e shkëlqyer
- Ngjitje në bojë alkide
- Ngjitje në sipërfaqe me ndryshk
- Depërtim i lartë në sipërfaqe me ndryshk
- Rezistencë kimike ndaj gërryerjes dhe ujit

PËRDORIME TË REKOMANDUARA

Rekomandohet të përdoret si bojë mbi të gjitha sipërfaqet metalike që janë të destinuara për përdorim në ambiente të brendshme dhe kryesisht të jashtme. Përdoret sidomos në ato raste kur kërkohet rezistencë shumë e lartë dhe kur sipërfaqet metalike janë të ekspozuara ndaj agentëve korrodues. Përdoret për lyerjen e konstruksioneve metalike që janë të destinuara për përdorim në ambiente industriale si për shembull kapanone, ura, shkallë, cisterna metalike, makineri, etj. Rekomandohet të përdoret kryesisht në industrinë detare për lyerjen e mjeteve të transportit, anijeve si edhe për makineritë e punës në zona portuale.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Rezina	Rezinë epokside
Densiteti EN ISO 2811-1	Komp. A 1,45±0,02 gr/ml Komp. B 1,05±0,02 gr/ml
Mbetja e thatë EN ISO 3251	65%
Raporti i përzierjes	4 : 1
Viskoziteti	105 ± 5 KU
Koha e tharjes mes dy shtresave	1 - 2 orë Në varësi edhe të kushteve të ambientit
VOC në produktin e gatshëm (Di rektiva Europiane 2004/42/EC) (g/l)	≤ 100
VOC emetimi në ambient, dhomë simulimi ISO 16000 (mg/m3)	≥ 20

PËRGATITAJ E PRODUKTIT

Bëni përzierjen e dy komponentëve dhe më pas hollimin e produktit duke përdorur solventin e duhur deri në viskozitetin e përshtatshëm për aplikim. Rekomandohet që përzierja e produktit me solvent të bëhet duke përdorur një mikser elektrik.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Pastroni sipërfaqet nga boja e vjetër e dëmtuar, e pa ngjitur dhe pjesët e ndryshkura duke bërë zmerilimin e sipërfaqes. Me anën e procesit të larjes eliminoni të gjithë pluhurat e krijuar nga procesi i zmerilimit si dhe elemente të tjera që pengojnë ngjitjen si graso, vajra, etj. Para aplikimit të produktit sipërfaqja duhet të jetë e trajtuar me astarin Epo Farbe SV.

APLIKIMI I PRODUKTIT

Aplikimi i produktit Epo Farbe SV bëhet me anën e një pistolette me ajër, me furçë ose me rrul. Fillimisht derdheni produktin e përgatitur në enën mbajtëse. Më pas me anën e pistoletës bëhet hapja e produktit mbi sipërfaqen e metalit. Aplikimi bëhet duke aplikuar dy shtresa të njëpasnjëshme në mënyrë që të bëhet mbulimi sa më i mirë i sipërfaqes së metalit. Sigurohuni që të përftohet spesori i duhur i shtresës në mënyrë që të arrihet mbrojtja maksimale e metalit. Pastroni mjetet e punës menjëherë pas përdorimit duke përdorur pastrues me bazë solventi.

PAKETIMI

Kanace 0.75lt

RUAJTJA

36 muaj, me kusht që kanaçet të jenë të mbyllura dhe në kushte normale ruajtjeje.

INFORMACIONI MBI SHËNDETIN, SIGURINË DHE MJEDISIN

Mbajeni larg fëmijëve produktin. Nëqoftëse gëlltitet lajmëroni dhe kërkoni ndihmën e mjekut dhe tregojini atij përmbajtjen e amballazhit. Mos e hidhni produktin në tubacione ose kanale.

SHËNIME

- Rekomandohet që të shmangët aplikimi i produktit në temperatura nën 5°C

